



Pranuar / Dorezuar Prilazur / Prilazur Received / Delivered	05.12.2022	2	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	SKIPMEHER	7683/2022	Sasia Kolicina Quantity
			115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.932/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.932/2022 të datës 20.10.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_

kundër Vendimit me numër protokolli 116-884 të datës 30.09.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.12.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.932/2022 e datës 20.10.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 116-884 i datës 30.09.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, më datë 20.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6327/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.932/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 116-884 të datës 30.09.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 21.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,



ndërsa kjo e fundit më datë 27.10.2022 ka dorëzuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 6327/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.932/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër protokolli 116-884 të date 30.09.2022 të Komisionit Disiplinor në MAPL; Emailin e datës 05.09.2022 për ankuesin nga Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.10.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 27.10.2022; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.12.2020; Vërejtjen me shkrim të datës 31.08.2022; Emailin e datës 19.08.2022 nga [ ] për [ ] Emailin e datës 17.08.2022, 29.07.2022, 25.07.2022 nga [ ] Draft raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për Vitin 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit; Procesverbalin e datës 12.09.2022, 19.09.2022, 26.09.2022 dhe 30.06.2022 të Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 18.08.2022 nga ankuesi për [ ] Emailin e datës 17.08.2022 nga [ ] për ankuesin; Emailin e datës 25.08.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 25.08.2022 nga [ ] dhe [ ] Emailin e datës 29.08.2022 nga ankuesi për [ ] Emailin e datës 16.08.2022 [ ] Emailin e datës 13.09.2022 nga [ ] për ankuesin; Emailin e datës 12.09.2022 nga [ ] për [ ] Emailin e datës 02.09.2022 nga [ ] Emailin e datës 31.08.2022 nga ankuesi për [ ] Emailin e datës 13.09.2022 nga ankuesi për [ ] Emailin e datës 14.09.2022 ng. Raporti i prezencës në punës për periudhën 01-31.08.2022 dhe 01.09.2022; Emailin e datës 01.09.2022 nga [ ] për ankuesin dhe Emailin e datës 01.09.2022 nga ankuesi për [ ]

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimit i provave materiale ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 19.02.2013 është i punësuar në pozitën e punës *Udhëheqës i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme* me linjë raportuese të Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datë 02.09.2022, ka iniciuar rast disiplinor për ankuesin [ ] për shkak të sjelljeve nënçmuese në vendin e punës, përdorimin e fjalëve fyese dhe shpifëse duke ju referuar e-mailit të datës 01.09.2022 si dhe për shkak të mos respektimit të orarit të punës.

Komisioni Disiplinor pranë organit përkatës të punësimit, pas mbajtjes se seancës dëgjimore me datë 12.09.2022, 19.09.2022 dhe 30.09.2022 ka konstatuar se ankuesi kishte bërë shkelje të dispozitave të Rregullores (QRK) - Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Kosovës, neni 9 paragrafi 1 dhe neni 10 paragrafi 1, për shkak se i njëjti me datë 31.08.2022 përmes e-mailit zyrtar i është drejtuar Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm duke mbajtur cc Ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku përveç disa shqetësimeve të tij i njëjti akuzon ministrin për shkelje ligjore në rastin e emërimit të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm, dhe përdor fjalë fyese në veçanti kundër Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm Venera Çerkini, ku nder të tjera i thotë se ajo

shquhet për paaftësi dhe për shkelje ligjore për ta mbrojtur pozitën në mënyrë neopotike. Ndërsa me datë 13.09.2022 ankuesi dërgon përsëri një e-mail në Komisionin Disiplinor, duke mbajtur cc Ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Zëvendësuesen e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësen e Personelit ku ai pretendon se Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm do të ndikojë në punën e Komisionit Disiplinor dhe në këtë rast do ta shkruaj ajo vendimin të cilin komisioni vetëm do ta nënshkruaj. Andaj, në këtë kuptim Komisioni Disiplinor konstaton se ankuesi ka kryer shkelje të rëndë disiplinore të paraparë me nenin 46 paragrafi 3, nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publike, dhe si rrjedhojë ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *Ndalim i 20% te pagës për një periudhë prej një muaji*”.

Kundër Vendimit me numër protokolli 116-884 të datës 30.09.2022 të Komisionit Disiplinor ankuesi me datë 20.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komisioni Disiplinor nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe rrjedhimisht nuk ka zbatuar drejt ligjin material sepse iniciimi i procedurës disiplinore nuk ka mbështetje ligjore dhe nuk ka asnjë argument, asnjë provë, dhe asnjë arsyetim se i kam shkelur dispozitat ligjore të konstatuara nga ky komision. Tutje ankuesi pretendon se Komisioni Disiplinor nuk ka shqyrtuar dhe vendosur sipas kërkesës se iniciuesit të procedurës por ka gjetur një bazë tjetër ligjore në mënyrë krejtësisht të paligjshme duke dëshmuar dhe argumentuar se nuk është i paanshëm. Po ashtu, ankuesi pretendon se Komisioni Disiplinor ka qenë në përbërje të paligjshme nën supozimin se kryesuesi i këtij komisioni duhet të jetë nëpunës civil i nivelit drejtues, respektivisht Drejtor i Departamentit, e jo Udhëheqës i Divizionit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se përbërja e Komisionit Disiplinor nuk ka qenë në pajtim me legjislacionin në fuqi, për shkak se kryesuesi i Komisionit Disiplinor duhet të ketë pozitë të nivelit drejtuese, gjegjësisht pozitë të Drejtorit të Departamentit, dhe jo pozite të Udhëheqësit të Divizionit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publike, përkatësisht nenin 49 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse, dhe paragrafin 6 te këtij ligji ku përcaktohet se: 6. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor dhe në Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, në përputhje me rregullat e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative.* Rrjedhimisht me dispozitat e Rregullore (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përkatësisht nenin 10 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *Çdo institucion i administratës publike i cili ka në marrëdhënie pune nëpunës civilë themelon një komision disiplinor për shqiptimin e masave disiplinore në rast të shkeljeve të rënda disiplinore të parashikuara në nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit. 2. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: 2.1. Nëpunës civil i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; 2.2. Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe 2.3. Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar.* Andaj, duke marr parasysh se me nenin 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullore (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, parashihet se kryesuesi i Komisionit Disiplinor duhet të jetë nëpunës civil i nivelit

drejtues dhe duke ju referuar nenit 33 paragrafi 2 nen paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publikë, ku përcaktohet se pozita e Udhëheqësit të Divizionit është pozitë e nivelit drejtues, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar. Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se inicimi i procedurës disiplinore nuk ka mbështetje ligjore, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publikë, përkatësisht nenit 48 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil, dhe si rrjedhojë duke marr parasysh faktin se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit është Sekretarin e Përgjithshëm, Kolegji i Këshillit vlerëson se inicimi i procedurës disiplinore nga Sekretari i Përgjithshëm nuk ka të meta ligjore në kuptimin procedural, dhe se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk qëndron.*

Kolegji i Këshillit po ashtu nga analizimi i vendimit të goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimit me numër protokollit 116-884 të datës 30.09.2022 të Komisionit Disiplinor, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka gjetur se ankuesi edhe përkundër faktit se ishte vonuar në takimin e datës 01.09.2022 të thirrur në ora 08:15 nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë, kishte dhënë arsytim të pa bazuar sepse mungesën e kishte arsyetuar për shkak të vonesave në ashensor, ndërsa sipas shkresave të lëndës, gjegjësisht hyrje - daljet e nëpunësve civil, ankuesi në ditën e njëjtë, gjatë hyrjes në punë ishte evidentuar në orë 08:31, nga rrjedh se në kohen kur ka filluar takimi në ora 08:15 nuk ka qenë në vendin e tij të punës. Përveç kësaj, ankuesi në e-mailin e datës 01.09.2022 dërguar mbikëqyrësit të drejtpërdrejt, kishte përdorur fjalë të cilat nuk përkojnë me sjelljen e nëpunësit civil, si citoj: ... *erdha me vonë por ju nuk më pranuar në mbledhje dhe Kosova ka shku poshtë qe u vonova pak.* Kolegji i Këshillit po ashtu nga shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesi edhe me datë 31.08.2022 përmes e-mailit zyrtar i ishte drejtuar mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë duke mbajtur cc Ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku përveç disa shqetësimeve të tij i njëjti akuzon ministrin për shkelje ligjore në rastin e emërimit të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm duke përdor fjalë akuzuese në veçanti kundër mbikëqyrësit të drejtpërdrejt, ku ndër të tjera i thotë se ajo shquhet për paaftësi dhe për shkelje ligjore për ta mbrojtur pozitën në mënyrë neopotike, ndërsa me e-mailin e datës 13.09.2022 akuzon mbikëqyrësin e drejtpërdrejt, gjegjësisht Zëvendësuesen e Sekretarit të Përgjithshëm se do të ndikojë në punën e Komisionit Disiplinor dhe në këtë rast do ta shkruaj ajo vendimin të cilin komisioni vetëm do ta nënshkruaj.

Kolegji i Këshillit vlerëson se secilit person i garantohet e drejta e sinjalizimit, gjegjësisht raportimit të informacioneve për një kërcënim ose cenim të interesit publik mirëpo një gjë e tillë duhet të bëhet vetëm përmes respektimit të dispozitave përkatëse ligjore. Andaj, duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publikë, përkatësisht nenit 25 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet se: 2. *Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës.* 3. *Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike, dhe sipas gjendjes faktike të vërtetuar si me lartë Kolegji i Këshillit konstaton se sjelljet e ankuesit në raport me mbikëqyrësin e drejtpërdrejt dhe stafin politik në këtë rast, me Ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, nuk përkojnë me sjelljen*

profesionale dhe etike të nëpunësit civil dhe si të tilla veprimet e ankuesit bien ndesh me rregullat e kodit të etikes, gjegjësisht nenin 5, 9 dhe 10 të Rregullores (QRK) - Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Kosovës (rregulla këto të aplikueshme në kohën e shqiptimit të masës disiplinore) dhe rrjedhimisht duke marr parasysh faktin se ankuesi sipas shkresave të lëndës në dosje personale kishte edhe një masë tjetër disiplinore "vërejtje", në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, i njëjti ka konsumuar elementet e shkeljes se rendë disiplinore nga neni 46 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, si dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 116-884 të datës 30.09.2022 ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe po ashtu drejt ka zbatuar ligjin material, duke shpallur ankuesin përgjegjës për shkelje të rendë të detyrave të punës dhe duke shqiptuar masën disiplinore në proporcion me shkeljen e vërtetuar dhe se në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit vendimi si i tillë është në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** Lënda me numër A.nr.932/2022.

**Avdyl BEKTESHI**

  
Procesmbajtës



#### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

